

MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

Ky 'Memorandum Mirëkuptimi' hyn në fuqi nga data **27 Shtator, 2023**. Memorandumi lidhet ndërmjet Universum International College, si partner strategjik i Universitetit Shtetëror të Arizonës ("ASU"), në njëjërë anë dhe në anën tjetër Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", Universitetit të Gjilanit "Kadri Zeka", Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani", Universitetit Polis, Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj, Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, Universitetit IBCM - Mitrovicë, Universitetit European të Tiranës-UET, Universitetit të Evropës Juglindore -Tetovë, Universitetit të Tetovës , Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup (në vijim "Palët").

1. **Qëllimi - Palët** dëshirojnë të bashkëpunojnë së bashku në mirëbesim për të promovuar "Iniciativën Globale për 100 Milion Studentë", në kuadër të Shkollës së Menaxhimit Global të Thunderbird, në kuadër të Universitetit Shtetëror të Arizonës.

Përpyjekja - Francis dhe Dionne Najafi, Iniciativa Globale për 100 Milion Studentë, sipas këtij bashkëpunimi do t'i ofrojë "Palës" edukim të klasit botëror në 40 gjuhë të ndryshme për studentët dhe partnerët e **Palëve** pa kosto në tre programe arsimore: i) Program i Avancuar; ii) Programi i Ndërmjetëm; dhe iii) Programi Themelor.

- a) Shkolla e Menaxhimit Global në kuadër të Universitetit Shtetëror të Arizonës do të angazhohet për:

- Njohjen e partneritetit midis Palëve të përfshira në këtë Memorandum të Mirëkuptimit.
- Përkthimin e kurseve dhe moduleve në dispozicion të Iniciativës për 100 Milion Studentë në gjuhën shqipe duke e bërë atë të qasshme për njerëzit në Republikën e Kosovë, Republikën e Shqipërisë, Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe më gjerë.
- Studentët e avancuar të këtij programi, të cilët janë rekrutuar nga Palët do të kenë mundësinë të aplikojnë për një bursë të mundshme për të përfunduar studimet Master në Thunderbird. Të gjitha çmimet e bursave do të përcaktohen vetëm nga komiteti i bursave në Thunderbird, sipas gjykimit të tij.

- c. Palët do të angazhohen për:

- Promovimin e Iniciativës 100 Milion Studentë brenda organizatës, partnerëve dhe publikut të tyre përmes rrjeteve sociale dhe kanaleve të tjera të komunikimit në vendet përkatëse dhe më gjerë duke përdorur këtë URL unike: <https://www.100millionlearners.org/register-info/?partner=UNI>

- Ofrimin e mbështetjes për të rekrutuar studentë gjatë tre viteve të ardhshme. Kjo përfshin studentë në nivelin BA dhe MA të studimeve.
- Të rritur vetëdijen e qytetarëve në vend përmes partneritetit me institucione tjera arsimore, biznese, qeveri dhe komunitetet lokale.
- Të mbështetur e iniciativën, duke shfaqur në mënyrë të dukshme Iniciativën për 100 Milion studentë në faqen fillestare të uebfaqeve zyrtare.

2. Kushtet e detyrueshme.

- a. Ky Memorandum Mirëkuptimi është jo detyrues dhe përfaqëson vetëm aspiratat aktuale të palëve në lidhje me këtë iniciativë. Asnjë detyrim, ofertë, marrëveshje apo detyrim tjetër ligjor nuk mund të krijohet përveçse me ekzekutimin e një Marrëveshjeje Përfundimtare nga Palët.
- b. Përfundimi/Zgjidhja. Ky Memorandum Mirëkuptimi përfundon/zgjidhet automatikisht dhe nuk ka fuqi apo efekt të mtejshëm pas (i) ekzekutimit të një marrëveshjeje përfundimtare me shkrim ndërmjet Palëve ("Marrëveshja Përfundimtare"); (ii) marrëveshjes reciproke me shkrim të Palëve; ose (iii) tri vite nga data e hyrjes në fuqi. Secila palë mund ta ndërpresë këtë marrëveshje pas një njoftimi me shkrim për palën tjetër me njoftim paraprak prej dhjetë (10) ditësh.
- c. Mbijetesat. Çdo dispozitë e këtyre Kushteve Detyruese që parashikon performancën pas zgjidhjes së kësaj marrëveshjeje, dhe të gjitha dispozitat e nevojshme ose të përshatshme për të interpretuar dhe zbatuar dispozitat e tilla, do t'i mbijetojnë përfundimit/zgjidhjes së kësaj marrëveshjeje.
- d. Konfidencialiteti. Për aq sa lejohet nga ligji, Palët do ta mbajnë këtë marrëveshje dhe diskutimet e tyre si konfidenciale. Mirëpo, asnjëra nga Palët nuk do të ketë asnjë detyrim për të ruajtur konfidencialitetin e informacionit që: (i) ka qenë tashmë në posedim të ligjshëm ose i njohur për Palën përpara datës së hyrjes në fuqi; (ii) është ose bëhet përgjithësisht i njohur për publikun, pa e shkelur këtë marrëveshje; (iii) është marrë ligjërisht nga Pala zbuluese nga një palë e tretë pa kufizime në zbulimin ose përdorimin; (iv) kërkohet të zbulohet nga një autoritet ligjor kompetent pas një njoftimi të arsyeshëm për Palën që nuk ka bërë të ditur; ose (v) është zhvilluar në mënyrë të pavarur nga Pala që nuk jep informacione.
- e. Detyrat. Asnjëra palë nuk mund të caktojë asnjë të drejtë pa miratimin paraprak me shkrim të Palës tjetër. Kjo marrëveshje mund të ndryshohet vetëm me shkrim dhe me nënshkrimin e Palëve.
- f. Miratimet. Me përjashtim të rasteve kur është rënë dakord me shkrim, asnjëra palë nuk ka të drejtë të bëjë gjërat në vijim: (i) të përdorë ndonjë emër, markë shërbimi, markë tregtare, emra tregtarë, logo, ose emra të tjerë identifikues, emra domenesh ose marka identifikuese të palës tjetër për ndonjë arsye, duke përfshirë qëllime

reklamuese ose promovuese; (ii) të lëshojë një deklaratë për shtyp ose deklaratë publike në lidhje me këtë marrëveshje; ose (iii) të përfaqësojë ose nënkuptojë ndonjë miratim ose mbështetje të ndonjë produkti ose shërbimi nga pala tjetër në çfarëdo komunikimi publik ose privat. Çdo përdorim i lejuar i Markave ASU duhet të jetë në përputhje me kërkesat e ASU, duke përfshirë përdorimin e treguesit ® të markës së regjistruar.


- g. Prona intelektuale. Asgjë në këtë marrëveshje nuk synon të transferojë ose të kalojë në ndonjë mënyrë tjetër ndonjë nga të drejtat e pronësisë intelektuale të Palëve tek njëra-tjetra ose tek ndonjë pale tjetër e tretë. Të gjitha të drejtat, titulli dhe interesat në pronësinë intelektuale të Palëve, qoftë patentë, e drejtë e autorit, sekret tregtar, marka tregtare, marka e shërbimit apo të drejtat morale, do të mbeten vetëm tek Palët përkatëse.

MIRATOHET;



Universum International College

Data: 27-09-2023




Universiteti "Hasan Prishtina" Prishtinë

Data: 27.09.2023


Universiteti "Fehmi Agani" Gjakovë

Data: 27.09.2023



Universiteti "Kadri Zeka", Gjiilan

Data: 27.09.2023



Universiteti "Isa Boletini" Mitrovicë

Data:




International Business College Mitrovica (IBC-M)

Data: 27.09.2023




Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj

Data: 27.09.2023




Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren

Data: 27.09.2023




Universiteti Polis

Data: 24/08/2023



Universiteti i Evropës Juglindore , Tetovë

Data: 27.09.2023



Universiteti i Tetovës

Data: 21.9.2023

Universiteti "Nënë Tereza në Shkup

Data: